



**POLICY
ANSWERS**

**SHKURTIMISHT PËR:
BASHKËPUNIMIN KOSOVË-
SHQIPËRI NË FUSHËN E
ENERGJISË: SI TË
PËRFITOHET MË SHUMË
NGA KOMPLEMENTARITETI?**

Responsible organisation: Riinvest
Institute

Date: November 2022



<https://www.facebook.com/WBInfoHub>



<https://x.com/wbinfohub>



<https://www.linkedin.com/company/wbinfohub/>

www.westernbalkans-infohub.eu

POLICY ANSWERS is funded by the European Commission through the Horizon Europe project "R&I POLICY making, implementation AND Support in the WEsteRn BalkanS", Grant Agreement N°10105887.



**Funded by
the European Union**

HYRJE*

Çështja themelore në këtë paraqitje të shkurtër (Policy Brief) është se si të përfitohet më shumë nga komplementariteti i theksuar në fushën e energjisë Kosovë - Shqipëri sa i përket burimeve energjetike dhe përmbushjes së nevojave për energji. Kjo natyrshëm do të duhej të rezultojë me një bashkëpunim më efektiv midis dy vendeve jo vetëm për tejkalimin e krizës aktuale që goditi të dy vendet me çmime tejet të larta dhe probleme furnizimi, por edhe për zhvillimin afatgjatë dhe optimizimin e të dy sistemeve energjetike ndërlidhur sidomos me sfidat e integritetit në BE dhe obligimet ndaj Agjendës së Gjelbër. Çështje që ngrihet për diskutim është nëse komplementariteti ndihmon në ngritjen e kapaciteteve për të mbuluar nevojat e tyre apo diçka e tillë mund të arrihet edhe pa këtë? Këto dhe disa dilema të tjera adresohen në këtë vështrim të shkurtër duke u përqasur me zhvillimet më të fundit të tregut të energjisë.

Shqipëria dhe Kosova ishin ndër vendet e para të prekura nga rritja e çmimeve të energjisë në fund të verës 2021 e që u përroll me shpalljen e emergjencës nga të dy qeveritë.² Në këtë kuadër, bashkëpunimi rajonal, e sidomos bashkëpunimi i ngushtë midis dy vendeve, behet thelbësor për rritjen e sigurisë kombëtare të energjisë. Për promovimin e një bashkëpunimi të tillë të dy qeveritë por edhe korporatat dhe sistemet operuese e rregullatorët kanë zhvilluar shumë diskutime, takime dhe marrëveshje e memorandume mirëkuptimi përgjatë gati dy dekadave. Por deri në fillim të dekadës së tretë nuk ka pasur rezultate aq të prekshme, përveç këmbimit të thjeshtë të tepcave, sidomos në situata të krizave të furnizimit. Pas aktivizimit të interkoneksionit të 400 kV si lidhja kryesorë strategjike e sistemeve energjetike të të dy vendeve dhe qasjes së Kosovës në ETNOS-e me shumë zhvillimesh, në tetor 2020, Shqipëria dhe Kosova kanë themeluar si shoqëri aksionare të përbashkët Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) në pronësi të operatorëve të sistemit të transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSST) përkatësisht 57.25% dhe 42.75%. Bursë që do të operojë në tregjet e ditës përpara dhe brenda ditës si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, duke adoptuar modelin unik evropian. Gjithashtu të dy vendet kanë themeluar tregun e përbashkët të energjisë dhe janë dakorduar për bashkëpunim në përmbushjen e nevojave të balancimit të energjisë.

* Publikuar nga Instituti Riinvest. Ky dokument është nxjerrë nga seria e debateve 'Green Talks' në kuadër të platformës Green Action Space, iniciativë e përbashkët e Institutit Riinvest dhe fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Në këtë debat (15.11.2022) u vendos në vëmendje të veçante çështja e rëndësishme e bashkëpunimit midis Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e energjisë. Në qendër të diskutimit të këtij paneli ishte se si të mund të përfitohet edhe më shumë nga komplementariteti. Penalistë ishin personalitete të spikatur, përfaqësues si të sektorit publik (Z. Sabit Gashi, Udhëheqës në Departamentin e Energjisë - Ministria e Ekonomisë së Kosovës dhe Z. Enea Karakaçi, Drejtor i Përgjithshëm për Energji dhe Industri në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë) sic edhe Dr. Ali Hamiti, Profesor në Fakultetin e Elektroteknikës, ish Drejtor i KEK-ut dhe udhëheqës i Rregullatorit për Energji, dhe Dr. Lorenc Gordani, Profesor dhe Udhëheqës i Studimeve Master në Universitetin për Biznes të Tiranës (TBU) dhe Këshilltar Ligjor për Çështjet e Energjisë). Diskutimi u moderua nga Prof. Muhamet Mustafa Këshilltar Senior në Institutin Riinvest. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Institutit Riinvest.

² Qeveria shqiptare së pari për 6 muajt e ardhshëm, deri më 15 prill 2022. Sa këtu u zgjat më tej deri në fund të vitit dhe tani deri në qershor 2023. E njëjta gjë për Kosovën, ku situata emergjente sipas ligjit, me afatet maksimale dy mujore, është zgjatuar deri më tani 7 herë.

Në fakt, sistemet energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë kanë nevojë urgjente të rrisin qëndrueshmërinë, fleksibilitetin dhe mbi të gjitha sigurinë e furnizimit. Bashkëpunimi midis dy vendeve tona konsiderohet si çelësi për të përballuar krizën e çmimeve të energjisë elektrike e cila i shtohet çështjes së pavarësisë energjetike, duke konvergjuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm, me efikasitet të lartë dhe kosto sa më të ulët për konsumatorin. Për të arritur këtë janë bërë përpjekje dhe ka zhvillime pozitive këto 2-3 vitet e fundit, mirëpo të gjithë këto pritjet të vihet në zbatim që të japin efekte sa më të plota.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Siç u tha më lartë vitet e fundit janë hedhur hapa të rëndësishëm, ku veçanti është se për herë të parë kemi krijuar një shoqëri të përbashkët publike lidhur me krijimin e bursës së energjisë ALPEX. Më herët po ashtu është finalizuar krijimi i bllokut të përbashkët të balancimit të dy zonave rregulluese Shqipëri-Kosovë. Sa këtu u realizua përmes një angazhimi të madh me ndihmën e ENTSO-E duke tejkaluar kundërshtitë e Serbisë.

Ne vijim të kualifikimit të projektit të Alkogap në listën e projekteve të interesit të përbashkët është vijuar me projektin e master planit të gazifikimit të Kosovës, kur ai i Shqipërisë është përfunduar shumë vite më herët. Së fundi me memorandumin midis dy qeverive për bashkëpunim dhe koordinim është krijuar një grup i përbashkët të cilët kanë filluar të shkëmbejnë ide për bashkëpunim drejt krijimit të një “federate të energjisë”. Megjithatë strategjia e Kosovës sa i përket gazifikimit mbetet e paqartë.

Çështja që ngrihet për diskutim është nëse komplementariteti vjen nëse kemi kapacitet maksimal në prodhim, pra njëri ose të dy vendet mbulojnë nevojat, apo vjen edhe pa këtë? Në fakt, për disa (si L. Gordani) ky është një limit i të konceptuarit (pra problem mendësie), pasi në ditët e sotme të pakta janë vendet që kanë pavarësi energjetike (p.sh. Evropa është e varur në rreth 50%), si dhe bashkëpunimi i plotë mund të arrihet fare mirë brenda mekanizmave të tregut (pasi bursa është orare dhe brenda se njëjtës ditë duke shitur e blerë në orë të ndryshme mund të dilet me një bilanc vazhdimisht pozitiv dhe plotësuar një pjesë të nevojave me kontrata afatgjate dhe instrumente mbrojtëse). Ajo që është esenciale është se nëpërmjet shfrytëzimit të komplementaritetit në fakt gjithë procesi i sigurisë energjetike dhe bashkëpunimit bëhet më lehtë i arritshëm dhe me një kosto efektive.

Natyrisht të gjithë bien dakord që duhet të vijohet të merren masa për mbulimin e nevojave të secilit, për të parë me tej si mund të ndihmohet njëri-tjetri dhe në situata emergjente që përjashtojnë tregun, por kjo duhet të jetë sa më e përkohshme. Siç pikërisht kjo do duhet të vijë duke aktivizuar potencialet e sektorit privat dhe që diçka e tillë të jetë e mundur duhet krijuar bursa e energjisë që çdo zhvillim të bazohet në sinjalet e tregut.

Thelbësore është se autoritetet publike dhe gjithë aktorët e tjerë e kuptojnë nevojën dhe nuk kanë asnjë dallim mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit. Edhe se më tej në praktikë, problemi mbetet se autoritet publike dhe një pjesë e madhe e akademisë mendon se për të pasur një sistem të përbashkët duhen burimet. Ndërkaq qasja tjetër është se nëpërmjet krijimit të një sistemi të përbashkët të dy vendet virtualisht zgjerojnë tregun e tyre rreth dyfish dhe kjo i lejon të marrin një rol më të rëndësishëm duke përfituar nga një planifikim më i mirë, zbutje e rreziqeve dhe marrjen përsipër të kontraktimit në avanse të blerjeve të energjisë së përbashkëta duke treguar “forcë”

më të madhe në treg, bërjen e investimeve të përbashkëta duke u mbështetur edhe nga financime në kredi dhe grante të donatorëve etj.

Aktualisht përpos infrastrukturës (interkonksioni) dhe infrastrutura legale (marrëveshjet midis dy qeverive që u theksuan më lartë), nuk ka projekte të përbashkëta të gjenerimit të energjisë elektrike me investime publike dhe private. Në çdo rast, bashkëpunimi në pikëpamjen e të gjithëve mbetet gjithsesi prioritet për arsye sigurie, operimi apo menaxhimi më të mirë (lidhur disbalancat e energjisë), shkëmbim në kohë reale etj. Dhe natyrisht bashkëpunimi duhet të jetë në formën e përshtatshmërisë së prodhimit të energjisë p.sh. PV, pastaj hidrot në Shqipëri, dhe në Kosovë prej qymyrit me përmbi 12 miliard rezerva lehtë të shfrytëzueshme.

Në veçanti, duke u fokusuar në ato që janë avantazhet e Shqipërisë, vendi ofron një nga kostot më të ulëta të prodhimit (LCOE) në rajon të hidrocentraleve dhe PV prej 30 Euro/MWh. Megjithatë nga pikëpamja e bashkëpunim deri me sot rastet e përfshirjes të investitorëve nga Kosova kanë qenë shumë të kufizuara. Ngjashëm është situata edhe investimeve shqiptare në Kosovë të cilat kanë potencial të zhvillimit me disa fish në sektorin e energjisë. Çështje këto të cilat duhet të marrin vëmendje maksimale, nisur edhe nga vlera e tyre ekonomike. Zhvillimi i sektorit të energjisë, i cili ngërthen përbrenda shumë sektorë të tjerë, të cilët vijojnë të mbeten motorët kryesorë të ekonomisë. P.sh. në Shqipëri lidhur vetëm me sa shikon energjinë dikur me një xhiro vjetore rreth 600 Mil/Euro sot ka arritur vlerën në 1.5-3 Mld/Euro në vit në varësi të asaj që është çmimi i energjisë në bursa.

FUSHAT POTENCIALE DHE DISA NGA PROJEKTET PRIORITARE TË PËRBASHKËTA

Avantazhet krahasuese të hidrocentraleve shqiptare (HEC-ve) lidhur ndër të tjera me mundësinë e balancimit të nevojave të dy vendeve por edhe të tregut rajonal, janë të padiskutueshme. Gjithsesi, edhe sot mbeten që rreth 44% të burimeve janë akoma të pashfrytëzuara të cilat do të ishin një baze e shkëlqyer për zhvillimin e çdo burimi tjetër të luhatshëm. Në këtë kuadër përfshirja e Kosovës në Projektin e HEC Skavicës u gjet me interes maksimal nga të gjithë folësit dhe të ftuarit në debatin e cekur më lartë.

Nisur edhe nga zhvillime të fundit lidhur me rritjen e çmimit të energjisë dhe situatën e emergjencës lidhur me konfliktin në Ukrainë në prioritetet e Qeverisë Shqiptare ka hyrë zhvillimi i burimeve të tjera të energjetike alternative nga era dhe dielli. Të dhënat e fundit tregojnë që projektet në sektorin e energjisë diellore tanimë janë me dhjetëra, që shkojnë nga 10 MW deri në 275 MW, ku më të mëdhenjtë janë me pjesëmarrjen ose në kërkim të partneritetit me investitorë të huaj për t'u zhvilluar. Ngjashëm drafti i strategjisë së zhvillimit të Energjisë në Kosovë deri 2031 parasheh rritjen e kontributit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë nga 6 në 32%. Ky mund të ishte një drejtim ku qeveritë e të dy vendeve mund të shikonin mundësinë e krijimit të kompanive të përbashkëta të cilat do gjenin mbështetje në kuadër të politikave për bashkëpunim rajonal (p.sh. kualifikimin si PECI).

Nga ana tjetër, Kosova ka një dominim të prodhimit nga linjitet, po ashtu është në një pozicion me thelbësor se Shqipëria lidhur me kalimin e rrjeteve ndërkombëtare, të pa shfrytëzuar sa duhet lidhur me elektricitetin apo edhe akoma e pa ndërlidhur me gazsjellësit ndërkombëtare (por me

potencial ne këtë drejtim). Te dy vendet mund të bashkëpunojnë lidhur me shfrytëzimin e potencialeve të linjitet në Kosovë për prodhim të gazit dhe kimizimin e thëngjillit në pajtim me zhvillimet teknologjike e kërkesat e Agjendës së Gjellbër. Një projekt i investimeve të përbashkëta mund të jetë edhe rivitalizimin e blloqeve ekzistuese të termocentraleve të TC “Kosovës A” për një periudhë 15-20 vite të tranzicionit energjetik.

Ne çdo rast, shume shpejt, pritët që shpejtë Bursa Shqiptare ALPEX, do të jetë likuide dhe kompanitë publike pjesë të bursave rajonale, duke përfshirë opsionet e bashkimit me rajonin, dhe vendet e BE-se si Italia dhe Greqia. Kjo do të bëjë që energjia elektrike të ndjekë sinjalin e çmimeve, në një treg reference shume me të gjere dhe besueshëm, dhe interesi të jetë dërgimi i energjisë aty ku është me e çmuar. Madje, në ditët e sotme, e vetmja që duke e sigurt është fakti se luhatjet e tregut do të përbejnë rregullin.

Ne këtë kuadër, konsiderim i veçante do duhet të jete si mund të përshtatemi dhe nxjerrim avantazhe në këtë kuadër të ri. Mbetet që diçka e tillë vjen përmes një procesi gradual dhe duke qene që me se shumti rregullohen nga direktivat sipas të cilave shtetet anëtare kanë detyrimin të arrijnë qëllimin e përcaktuar duke ndjekur rrugët më të përshtatshme për ta.

Në draftin e Strategjisë së Kosovës për periudhën 2022-2031 është theksuar rëndësia e bashkëpunimit lidhur me integrimin e tregut (në vitin 2023), funksionalizimit i plotë bursës APEX si dhe rritjen e planifikimit të përbashkët energjetik. Në aspektin e investimeve të përbashkëta janë theksuar (bashkë)investimi në termocentralet me gaz natyror lidhur me opsionin e shfrytëzimit të infrastrukturës së gazit që është planifikuar në Shqipëri (lidhja në TAP ose qasja në terminalin e LNG në Vlorë; si dhe që deri në fund të dekadës do të ndërtohen linja të reja interkonektive ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, për të mundësuar tregti më të madhe në rajon).

Vlen të theksohet se një komplementaritet aq i theksuar e shtron nevojën që dokumentet strategjike të zhvillimit të këtij sektori kaq të rëndësishëm në të dy vendet të harmonizohen dhe të përmbajnë edhe pjesën e politikave dhe të projekteve të përbashkëta. Kjo do të duhej ta mbështetej me infrastrukturën institucionale dhe gjithçka tjetër tanimë të formësuar si dhe me krijimin e një trupi koordinues të të dy qeverive për të nxitur dhe përcjellë përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta zhvillimore.

Pikërisht për këtë, e rëndësishme është që çdo hap ta hedhim të mirë përgatitur por edhe të ecim përpara pa ndaluar. Në këtë drejtim, mund të themi se jemi në një kohë që po shënon një kapërcim në një etapë të re historike, e cila hap mundësi të pafundme për t'u vënë në jetë. E ardhmja, siguria dhe qëndrueshmëria e këtij sektori është kyç për ekonominë e të dy vendeve. Për këtë arsye, është reale nevoja për të kultivuar bashkëpunimin ndërsektorial jo vetëm në nivel publik të investime, sipërmarrje, etj., por edhe lidhur me sektorin privat për sa shikon produkte, shërbime, por edhe në gjetjen e zgjidhje të reja dhe inovatore.

REKOMANDIMET

1. Rekomandohet që Qeveria e Shqipërisë dhe Qeveria e Kosovës të vazhdojnë dhe thellojnë bashkëpunimin për të përballuar problemet që sjell kriza aktuale energjetike, nevojat e zhvillimit afatgjatë strategjik dhe të tranzicionit energjetik në frymën e Agjendës së Gjellbër.

2. Bashkëpunimi duhet të pasurohet dhe avancohet duke i realizuar marrëveshjet e bashkëpunimit lidhur me tregun e përbashkët energjetik, funksionalizimin e Bursës Energjetike ALPEX, planifikimin e balancimeve të nevojave dhe të përmbushjes së tyre. Kështu, te dyja vendet duhet të shikojnë me përparësi zgjerim e bashkëpunimit mbi aspektet tregtare p.sh. duke themeluar kompani me kapital të përbashkët për shitblerjet e energjisë me qëllim të rritje së peshës së përfshirjes në bursat e rajonit dhe për zgjerimin e tregut të referencës.

3. Bashkëpunimi duhet të ngritet në një nivel më të lartë sidomos duke ndërtuar partneritete me investime të përbashkëta lidhur me projektet me rëndësi startegjike si:

(a) Rezervat hidrikë të Shqipërisë duhet të gjejnë një përdorim të koordinuar mbi baze tregu për balancimin e sistemit. Projekti i HEC Skavicës, duhet të synoj domosdoshmëri përfshirjen e Kosovës duke qenë se një pjesë e rëndësishme e pellgut ujqor shtrihet në Republikën e Kosovës (nga ana tjetër edhe zhvillimi i këtyre projekteve në pjesën *upstream* mund të vijë në mënyrë që nuk sjellë shqetësime në pjesën e mëposhtme).

(b) Te dyja qeveritë duhet të dalin me një listë të përbashkët mbi projektet ku ekziston mundësia e bashkëpunimit. Kështu së fundmi qeveria shqiptare ka shprehur gatishmërinë për përfshirje në terminalin e gazit natyror të lëngshëm (LNG) në Portin e Vlorës. Për këtë dy vendet kanë nënshkruar një memorandum për të marrë energji elektrike ose gaz natyror. Përfshirje e cila do të ulte kostot dhe bënte edhe më të realizueshëm këtë projekt rajonal.

(c) Një projekt i investimeve të përbashkëta mund të jetë edhe rivitalizimin e blloqeve ekzistuese të termocentraleve të Kosovës A për një periudhë 15-20 vite të tranzicionit energjetik.

(d) Nxitjen e investimeve të përbashkëta dhe partneritetit për burimet ripërtëritshme energjetike (PV, energji nga era, e të ngjashme).

4. Zhvillimet të cilat duhet të behën publike për të marrë me tej mbështetjen e futjes së tyre në një listë për zhvillimin e fizibiliteteve teknike të tyre. Studime të cilat duhet të përgatiten në nivel të tillë që të favorizoj përfshirjen e kapitaleve të të dyjave vendeve si publike dhe private.

5. Te dyja vendet duhet të shqyrtojnë me përparësi mundësinë për të ofruar maksimumin e lehtësirave për arritjen e objektivit të pavarësisë energjetike dhe masave me të gjera për të përthithur në këto projekte kompanitë kombëtare, publike dhe private të të dyjave vendeve.

6. Për ashtu, dy qeveritë duhet të krijojnë një organ unik këshillues në nivel teknik për të konkretizuar ndërtimin e një strategjie të përbashkët dhe monitorimin e zbatimit të saj në praktik. Organ që propozojmë të kualifikohet si Këshilli Kombëtar për Energjinë (ngjashëm me eksperiencën në fusha të tjera me rëndësi), si një forum/organ konsultativ, mund të nxisë dialogun në nivel sa më të gjerë pan-kombëtar.

Në mbyllje të sa këtu me sipër shprehim besimin se adresimi i mundësive në rritje në sektorin e energjisë, bëjnë të domosdoshme nxitjen duke rritur rrjetëzimin dhe marrëdhëniet me partnerët kombëtarë dhe rajonalë e globalë, duke filluar së pari midis dy vendeve tona për tu paraqitur me atraktive dhe të vlefshëm dhe peshë në këtë trend global. Pra, ky transformim nuk është as formal dhe as i lidhur me një autoritet publik, por përbën një proces të vazhdueshëm ku një rol të veçantë ka sektori privat. Sfidat që mund të tejkalohen pra vetëm kur institucionet shtetërore, kompanitë dhe bizneset shtetërore, arsimit, ekspertët e lartë dhe palët e tjera të interesit bashkëpunojnë në interesin më të mirë publik.